



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 119 Prot.

Tiranë, më datë 07.02.2023

VENDIM
Nr. 43, datë 07.02.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 07.02.2023:

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit të vëzhgimit arkeologjik për projektin “Kompleks banimi me vila individuale 1 dhe 2 kate me 1 kat nëntokë, me pishina dhe mure rrethues, Mjull-bathore, Tiranë”, me aplikues “V-Konstruksion” dhe zhvillues “Delta Cooperation and Investment” sh.p.k.;
2. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje rastësore, në zbatim të Ligjit 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 145-147, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohen pranë IKTK-së siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Eugen KALLFANI

